



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 20 QERSHOR 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 20. JUNA 2013. GODINE**

**QERSHOR - JUN
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me rirregullimin e taksave të sigurimeve të automjeteve të udhëtarëve dhe automjeteve transportuese të mallrave,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që e rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012,
7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2012,
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2012,
9. Shqyrtimi i kërkesës për transferin e mjeteve nga Ministria e Punëve të Brendshme në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Glasanje o porukama sa održane parlamentarne debate u vezi sa preuređivanjem taksu osiguranja putničkih automobila i transportnih vozila za robu,
5. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji prvog međunarodnog sporazuma o principima koji regulišu normalizaciju odnosa između Republike Kosovo i Republike Srbije,
6. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Radiotelevizije Kosova za 2012.god,
7. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Fonda penzijskih štednji Kosova za 2012.god,
8. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o radu Kosovskog saveta za kulturno nasleđe za 2012,
9. Razmatranje zahteva za transfer sredstava iz Ministarstva unutrašnjih poslova u Ministarstvu životne sredine i prostorno planiranje.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje kolegë deputetë,

Unë do ta ngre shqetësimin edhe të Komisionit, edhe timin, edhe të qytetarëve dhe banorëve të atyre që janë mbrojtës të natyrës.

Ne e kemi një vendim dhe një master-plan nga Ministria e Industrisë dhe Tregtisë për ‘Brezovica 2’, ndërsa me master-planin e Ministrisë është planifikuar të ndërtohet një vend i turizmit, me të cilën kërkohet që zona e parë e mbrojtur, e shpallur nga ekspertët, të cilët Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor i ka kërkuar, i ka zgjedhur ato në bazë të shkencës ose doktorëve të shkencës, që merren me shpalljen e zonave. Në këtë aspekt, në planin ‘Brezovica 2’, Ministria e ka master-planin.

Unë i kam edhe fotografitë këtu, e kemi në sllajde atje dhe e kemi vendimin e Qeverisë dhe të ministrisë që e kanë bërë këto zona të shpallura. Është zonë para vendimit, ku njerëzit ekspertë të fushave të natyrës, në bazë të ligjit të natyrës, në bazë të direktivave evropiane për mbrojtjen e atyre habitateve, të kafshëve, të bimëve të florës dhe të faunës, dhe e kemi një vendim të Ministrisë së Industrisë dhe të Tregtisë, të zonjës Mimoza Kusari-Lila, e cila kërkon që zonën e parë ta shtyjme më tutje, duke menduar se kjo është një farë parcele prone, dhe ta bëjmë një bartje.

Me këtë vendim, ja ku e kam edhe vendimin e ministres, me të cilin i është drejtuar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, por i kam edhe të gjitha dokumentet në bazë të ligjit të natyrës, dhe çështja e biodiversitetit, direktivat evropiane për llojet të rrezikuara, direktivat evropiane për habitatet, direktivat evropiane për ruajtjen e zogjve, kafshëve e të tjera.

Në vendin ku kërkohet, mund ta shihni edhe në sllajde, të ndërtohet një Brezovicë e dytë dhe një Prevallë, po ashtu atje është një qytezë me 200 shtëpi, të cilat tregojnë që ministria kërkon vetëm përfitime materiale, por jo edhe mbrojtje të natyrës, në bazë të ligjeve dhe direktivave.

Ne e kemi shpallur park edhe këtë e kemi bërë për mbrojtjen, sepse ka vlera të natyrës, ka vlera në bazë të konventave ndërkombëtare për parqet.

Kompleksi ‘Brezovica 2’, ose Brezovica që është sot, e ka një kapacitet prej 52 mijë shtretërve, të cilët mund të bëjnë funksional dhe Kosova me resurset humane, apo resurset...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Nait, koha u harxhua. Nëse grupi t’i jep edhe dy minuta, vazhdo në emër të grupit. Në emër të grupit ka të drejtë të flasë, e ka temën e mirë.

NAIT HASANI: Faleminderit!

Kompleksi Brezovica i ka sot diku rreth 52 mijë shtretër, që Kosova nuk ka mundësi ta plotësojë. Prandaj, kërkohet që të funksionalizohet Brezovica, e të mos preket kjo pjesë e natyrës, e cila është pjesë e vlerave që e kemi shpallur park Bjeshkët e Sharrit të Parkut Kombëtar.

Nëse kjo pjesë hiqet dhe ndërtohen ato 200 shtëpi, nëse këtu e kemi një përfitim material që është kërkuar nga Ministria e Industrisë dhe e Tregtisë, e ajo ka nevojë të bëjë tregti, t’i shet me miliona kubik dru, të cilat do të japin përfitime të jashtëzakonshme materiale. Por, do ta kemi një shkatërrim të natyrës, të cilin nuk do të kemi mundësi gjenerata e gjenerata ta rigjenerojmë dhe ta kthejmë në gjendjen normale, ose në gjendje të cilën është tash.

Krijimi i planit ‘Brezovica 2’ do të thotë krijim edhe një Prevalle të dytë, të cilën nuk po mund ta rregullojmë, ta ndërtojmë ose ta kthejmë në gjendjen normale, e prej vitit 2006 jemi kah merremi me Pervallën.

Prandaj, kërkesa jonë, edhe e imja, edhe e Komisionit, edhe e ekspertëve që e kanë shpallë si zonë e mbrojtur prej vitit 2006, kur është zgjedhur komisioni, është që kjo zonë të mbrohet, kjo zonë të jetë pjesë e natyrës, pjesë e mbrojtjes, sepse nëse i shkatërrojmë këto, e kemi shkatërruar të ardhmen tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dola sot këtu ta marr fjalën për të ndarë disa shqetësime lidhur me raporte ndërkombëtare për kualitetin e qeverisjes në Kosovë. I fundit nga këto është edhe raporti i “Freedom House”, i cili jep vlerësime për shqetësime serioze për nivelin e demokracisë dhe orientimet demokratike të vendit.

Është bërë modë që ne t’u drejtohem si pikë reference raporteve ndërkombëtare, sepse fatkeqësisht ka humbur besimi në vlerësimet politike dhe vlerësimin të institucioneve të pavarura vendore. Por, fatkeqësisht, në të njëjtën kohë, këto raporte ndërkombëtare verifikojnë qëndrimet e grupeve politike dhe vlerësimet politike, edhe të Lidhjes Demokratike, por edhe të organizatave të shoqërisë civile dhe të organizatave tjera, të

cilat merren me nivelin dhe vlerësimin e nivelit të demokracisë dhe nivelet tjera të qeverisjes.

Ky raport, për nivelin e përgjithshëm të demokracisë për Kosovën, vlerëson se Kosova është një sistem autoritar gjysmë i konsoliduar, që i bie që Kosova, me fjalë të tjera, është gjysmëdiktaturë. Dhe i bie që Kosova fatkeqësisht hy në nivelin e vendeve si Kirgistani, Taxhikistani, Kazakistani, Azerbajxhani, Bjellorusia, Turkmenistani, Uzbekistani. Këto janë shtetetme të cilat Kosova krahasohet dhe kjo është fatkeqësia për të cilën ne mund të themi sot se është niveli më i ulët i mundshëm i demokracisë dhe i përfaqësimit qytetar.

Te niveli i problemeve, në qoftë se e marrim dhe e shohim krahasimin e Kosovës me vendet e Ballkanit, na del sesa i përket procesit elektoral, Kosova është më së keqi e renditur.

Sa i përket rolit të shoqërisë civile dhe përfshirjes së saj në vendimmarrje është më së keqi e renditur. Sa u përket medieve të pavarura, Kosova është më së keqi e renditur. Në qoftë se këtu i shtohen edhe veprimet e fundit që kanë ndodhur, kjo është tragjike në të njëjtën kohë.

Sa i përket nivelit qendror të qeverisjes Kosova është më së keqi e renditur në Ballkan. Sa i përket demokracisë lokale, Kosova është më së keqi e renditur në Ballkan. Sa i përket sistemit të drejtësisë dhe pavarësisë së drejtësisë, Kosova po ashtu është më së keqi e renditur. Sa i përket nivelit të korrupsionit dhe luftës kundër korrupsionit, Kosova po ashtu është më së keqi i renditur.

Kjo tregohet me ngjyrën e kaltër në këtë diagram, i cili fatkeqësisht konfirmon shqetësimet e vazhdueshme të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të institucioneve të pavarura, të cilat merren me monitorimin e kualitetit të qeverisjes dhe sistemit të qeverisjes në Kosovë.

Në qoftë se i marrim dhe i shohim një nga një problemet të cilan paraqitet edhe me të cilat sfidohet sot Kosova, janë:

- Procesi elektoral - fatkeqësisht kjo ka qenë e pritshme, sepse duke marrë parasysh se në këtë vend ka ndodh vjedhje industriale të votave, mungesë e vullnetit politik nga Partia Demokratike e Kosovës për reformën zgjedhore dhe për ngritjen e kualitetit të zgjedhjeve, kjo ka qenë e pritshme.

- Roli i shoqërisë civile - në qoftë se shoqëria civile kërcënohet, shantazhohet, bllokohet, por në të njëjtën kohë nuk ka asnjë formë të kooperimit dhe të përfshirjes së saj në proceset e transparencës në vendimmarrje, atëherë normalisht është e pritshme që kjo do të ndodhë.

- Sa i përket medias së lirë - media e pavarur në Kosovë është koncept tashmë abstrakt, sepse mediat në Kosovë kërcënohet, shantazhohet dhe në qoftë se guxon të flasë kundër Qeverisë delokohet nga një pozitë e vendit të tretë për shembull që ka ndodhur me KTV-

në, kompaninë ‘Koha’ e të tjerë, shkon në vendin e 83-të, e kjo është një shkelje e rëndë e lirisë së mediave dhe një perceptim për shtetin e Kosovës.

- Në qoftë se e shohim nivelin e qeverisjes - niveli qendror i qeverisjes, po ashtu edhe kjo është e pritshme, duke marrë parasysh çfarë Qeverie kemi, si rezultat i çfarë votave ka ardhur, kombinimet e kësaj qeverisje dhe e kësaj Qeverie dhe rezultatet dhe performansa e përfaqësimit të vullnetit të qytetarëve, kjo ka qenë e pritshme dhe kjo fatkeqësisht ka ndodhur.

- Në qoftë se e marrim nivelin lokal të qeverisjes, në qoftë se e marrim edhe e shohim se shumica e kryetarëve të komunave nga Partia Demokratike e Kosovës, njëra në akuza nën hetime për vepra të ndryshme, edhe kjo reflektohet në raportin e “Freedom House”.

- Në qoftë se e marrim dhe e shohim sistemin e drejtësisë, mbi 200 mijë lëndë janë të pakryera, të papërfunduara, dhe këto lëndë janë mungesë e dhënies së drejtësisë dhe mungesë e qasjes në drejtësi, atëherë normalisht që është e pritshme.

- Në qoftë se shohim nivelin e korrupsionit në vend me të gjitha këto akuza për korrupsion dhe me gjithë këtë nivel të keq-qeverisjes, normalisht që është e pritshme kjo.

Të gjitha këto së bashku japin dy elemente kryesore, apo dy pasoja kryesore.

Pasoja kryesore e parë është në kualitetin e qeverisjes dhe perceptimi qytetar për shtetin e tyre, e kjo po jepet fatkeqësisht shumë keq me besueshmërinë e qytetarëve të Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Është shqetësuese se shteti i Kosovës po degradon. Kjo nuk është një gjë e re, sepse ky degradim ka filluar tash e një kohë të gjatë, dhe në disa aspekte natyrisht ka filluar që në ngjizjen e tij. Por, çka është e re sot është se degradimi ka marrë shpejtësi. Ai tash po ndodh në baza ditore.

Sovraniteti i ndarë, kjo varësi e re e Kosovës nga Serbia, që rrjedh nga marrëveshja ndërmjet Thaçit e Daçiqit ka filluar ta marrë formën e vet. Dhe sikur që është marrëveshje e dëmshme dhe në kundërshtim me rendin kushtetues e juridik të vendit, kjo marrëveshje ashtu po e përdhos rendin procedural të institucioneve tona: ajo ishte futur në rendin e ditës për seancën e sotme, e tash nga kryeministri është kërkuar të tërhiqet, pa e marrë asnjëherë mendimin e Gjykatës Kushtetuese për kushtetutshmërinë e saj.

Ndërkohë që efektet e saj tashmë kanë filluar të marrin formë. Pra, edhe ajo që po thuhet se kërkon ratifikim, po gjen zbatim pa u ratifikuar.

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e fundit, të mbajtur më 17 qershor, e ka miratuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit numër 03/L-40 për vetëqeverisjen lokale, që ndërlidhet me pikën 2 të marrëveshjes për ta kodifikuar kështu ligjërisht procedurën e shpërbërjes së asociacionit së komunave me shumicë serbe.

Zgjedhjet lokale nuk po shpallen dot pa u dakorduar me Serbinë. Kosova nuk vendos dot asnjë çështje që ka të bëjë me energjinë, telekomin, infrastrukturën pa u dakorduar njëherë me Serbinë.

Dje u kuptua edhe një gjë; që zyrtarët shtetërorë të Kosovës tash e tutje nuk do ta kenë të drejtën as ta shprehin kërkesën për njohje të Republikës së Kosovës nga Serbia. Përndryshe, do të detyrohen të tërhiqen, siç i ndodhi Lulzim Peci, i cili të hënën e nisi detyrën e tij të re të zyrtarit për ndërlidhje në Beograd. Pasi nuk guxojnë ta shprehin, shpejt nuk do të guxojnë as ta mendojnë. Ky është efekti i marrëveshjes: Republika e Kosovës nuk do të ketë të drejtë të kërkojë njohje nga Serbia. E shteti i shpallur i pavarur, i cili nuk kërkon njohje, nuk mund të jetë shtet i pavarur, apo jo? Pra, nëse krerët tonë institucional nuk presin njohje nga Serbia, siç ka thënë në më shumë se një rast kryeministri Thaçi, dhe nuk guxojnë ta thonë një gjë të tillë në publik, atëherë këtu e kemi një varësi shumë serioze.

Ndërkohë që pjesën më të madhe të aparatit tonë shtetëror e kemi të zhvendosur tashmë në Bruksel. Përfaqësues të Ekzekutivit dhe të agjencive tona shtetërore, të KQZ-së, të Këshillit Gjyqësor, prokurori i Shtetit, Gjykata Supreme, rregullatorët e energjisë, të telekomit etj., janë futur në negociata të vazhdueshme me Serbinë. Tash vendimet për Kosovën më nuk po merren në Kosovë, por në Bruksel, në bashkëpunim me Serbinë. Çfarë janë këto mbledhje të përbashkëta vendimmarrëse me Serbinë? Dhe, ku guxojnë këto poste publike kushtetuese të marrin vendime jashtë vendit dhe bashkë me një shtet tjetër?

Ky degradim natyrisht që duhet ndaluar. Kërkesa e vazhdueshme e kryeministrit të Kosovës që të heqim dorë nga shtetndërtimi është realisht kërkesë e Serbisë, që e bën këtë kryeministër pro Serbisë. Aleatët e tij në këtë ndërmarrje kundërshtetërore e kundërkushtetuese nuk janë me më pak faj. Dhe, ata nuk janë vetëm ndërkombëtarë, ata janë edhe vendorë, pra janë edhe në këtë Kuvend.

Prandaj, në vend se të heqë dorë nga shteti, Hashim Thaçi duhet të heqë dorë nga pushteti. Ky kryeministër duhet të largohet, së bashku me Qeverinë e tij.

Kjo strukturë e këtij Kuvendi, që po ia mundëson e lehtëson këtë degradim të shtetit këtij kryeministri, duhet të largohet po ashtu. Sepse, Kosova ka nevojë për institucione të Kosovës, që punojnë për Kosovën dhe për popullin e saj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!
I nderuar kryetar i Kuvendit,

Deputetë të nderuar,

Tema që unë sot do ta diskutoj ka të bëjë me buxhetin e shpenzuar nga Ministria e Shëndetësisë nga vija buxhetore për trajtimin e pacientëve jashtë institucioneve publike shëndetësore.

Shumë herë në Kuvendin e Kosovës u bë temë çështja e hapjes së Repartit të Kardiokirurgjisë. Bile për këtë u dhanë data të rëndësishme historike të mundshme për hapjen e këtij shërbimi, 28 Nëntori, apo 100-vjetori i pavarësisë së Shqipërisë, e më pas, pasi kjo datë dështoi, si datë e radhës u dha 17 Shkurti ose 5-vjetori i shtetësisë së Kosovës.

E në fakt, ky shërbim u hap më 13 mars, që shihej si shpresë për pacientët që deri tash janë detyruar të kërkonin shërbime edhe jashtë shtetit, kosto që i ka kushtuar Ministrisë së Shëndetësisë, por edhe pacientëve.

Këto ditë, nga disa deklarata u dhanë shifrat e parave të shpenzuara për pacientët nëpër institucione privatet shëndetësore.

Në top-listë nga këto institucione shëndetësore private është ‘Medicin Hospital Internacional’, me 711 800 euro, ‘Rezonanca’, ‘Kubati’ e kështu me radhë.

Unë e kuptoj se edhe për këto shërbime ka pasur nevojë dhe emergjenca. Transferet qështë janë rregulluar me një udhëzim administrativ dhe familjarët është dashur ta plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm paraprakisht, në mënyrë që trajtimi apo stendat t’u paguhen nga Ministria e Shëndetësisë.

Mirëpo, këtë privilegj nuk e kanë pasur pacientët që me urgjencë kanë shkuar nëpër këto klinike private nga spitalet rajonale, edhe pse udhëzimet kanë qenë nga mjekët kardiologë apo internistë.

Shtrohet pyetja: Sikur jo krejt, por veç gjysma e këtij buxheti, që është shpenzuar nëpër këto klinika private, të ishte investuar në Qendrën Klinike Universitare, konkretisht në Kardiokirurgji, tash kjo klinikë do të ishte shumë efikase, sepse e posedon kuadrin profesional dhe këtu do ta kishim të garantuar vazhdimësinë e punës.

Pyesim ministrin, çka me pacientët e radhës? Si mendoni t’i ndihmoni, meqenëse veç gjysma e vitit ka kaluar, e buxheti gati është shpenzuar, duke e llogaritur numrin e madh të aplikacioneve të dorëzuara në Ministrinë e Shëndetësisë.

Të nderuar deputetë,

Dhe ju qytetarë të Kosovës,

Nuk po dua të them se ka ndonjë lidhje interesi apo kontratë interne të ministrisë dhe të këtij spitali, nuk po dua të them se ka korrupsion dhe të thënat e tjerë nga pacientët, mjekët e ndryshëm, por unë po pyes: A ka këtu transparencë dhe llogaridhënie?

Kam kontaktuar shumë profesionistë shëndetësorë në këtë klinikë dhe ja si janë të dhënat e tyre në lidhje me këtë çështje.

Materiali që harxhohet për një koronografi është rreth 150 euro, për stentë deri në 350 euro...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, edhe dy minuta, në emër të Grupit.

TIME KADRJIAJ: ...në sektorin publik. Në sektorin publik me 700 mijë euro material do të kryheshin rreth 2 000 koronografi dhe 1 000 stentime. Në sektorin privat, një koronografi me stentim kushton minimum 4 000 euro dhe varion prej 6 000 - 9 000 euro. Me fjalë të tjera, me shumën e të hollave që një pacient paguan në sektorin privat, mund të kryhen 8 pacientë në sektorin publik. Më thjesht, me 700 mijë euro material në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës do të bëhej punë që të kursenim 5,5 milionë euro, sa do të kushtonte privatë.

E në fund shtrohet pyetja: A guxon kjo Qeveri e Kosovës ta lejojë një menaxhim të tillë? Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Unë e kam një shqetësim lokal, që nuk është vetëm lokal. Në grumbullin e shqetësimeve të përgjithshme, do të veçoj problemin dhe shqetësimin e etheve hemorragjike, nga të cilat para pak ditësh, në Balincë të Malishevës e kemi varrosur viktimën e tretë këtë vit.

Viktima e parë ishte në Zatriq të Rahovecit, e dyta ishte para se ta ngrija këtë shqetësim në Astrazub të Malishevës, e treta në mes të këtyre dy seancave ra në Balincë të Malishevës. Edhe sa viktima duhet të bien nga ethet hemorragjike që ne si shoqëri, institucionet si organe përgjegjëse për sigurinë e qytetarëve duhet ta bëjnë shqetësim emergjent dhe ta trajtojnë me urgjencë dhe në mënyrë të veçantë.

Unë në këtë seancë i propozoj Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Ambientit dhe Ministrisë së Financave që të bashkohen në një takim emergjent me njerëz kompetentë, me kuadro kompetente, që ta trajtojnë këtë problem, të ndajnë fonde dhe të bëjnë një program për dezinfektim për ta ndryshuar këtë gjendje, sepse është rasti kur nuk duhet të neglizhohet, kur nuk duhet të nënçmohet. Përndryshe, po të bëhet edhe më e përhapur, do të bëhej problem edhe jashtë suazave të institucioneve të Qeverisë sonë.

Për veten time kam besim në kryeministrin, kam besim në ministrat përgjegjës të këtyre ministrive dhe kam besim në të gjitha kuadrot, të cilat janë përgjegjëse për ta trajtuar këtë shqetësim qytetarëve tanë të Malishevës, të Prizrenit, të Rahovecit, të Therandës dhe të

Klinës, atje ku një fshat që quhet Jashanicë e ka një shqetësim të jashtëzakonshëm tani këto ditë dhe ka një vërshim në ambulancat e qyteteve përkatëse, ku janë qindra të thumbuar nga pickimi i rriqrave helmuese dhe natyrisht edhe ata që nuk pësojnë e nuk përfetojnë vdekjen, mbjellin shqetësim me ditë të tëra, me javë të tëra, me familjet e tyre deri...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e vazhdoj aty ku e la kolegu deputeti Halit Krasniqi, sepse shqetësimi është i njëjtë dhe vërtet është shqetësuese dhe alarmante për qytetarët e komunës së Malishevës dhe katër komunat përreth që ka të bëjë pikërisht me këto ethe hemorragjike.

Dhe, unë e kam shqetësimin pikërisht te çështja e buxhetit, ku niveli lokal dhe po ashtu niveli qendror e ndajnë një buxhet shumë të limituar dhe kanë mundësi që ndoshta të mos realizojnë investim kapital, si në nivelin lokal, po ashtu edhe në nivelin qendror dhe ato mjete t'i dedikohen hartimit të një strategjie, e cila do t'i eliminonte rriqrat, të cilat ekzistojnë, sidomos në komunën e Malishevës dhe në komunat përreth.

Unë u shpreh ngushëllimet e dy familjeve, familjes Morina nga Astrazubi dhe familjes Thaçi nga Balinca, dhe njëkohësisht u uroj shërim sa më të shpejtë gjashtë pacientëve, të cilët janë duke u trajtuar në Klinikën Infektive.

Por, vërtet kërkoj nga Qeveria e Kosovës që të marrë masat e duhura dhe urgjente që ta hartojë një strategji për eliminimin e kësaj dukurie, që është shumë alarmuese në komunën e Malishevës dhe komunat përreth. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Shqetësimin të cilin dua ta ngre sot unë ka të bëjë në lidhje me komunikatën, të cilën dje e ka lëshuar Ministria e Punëve të Jashtme në drejtim të ambasadorit Lulzim Peci.

Është një komunikatë, e cila, gjëja që më pak mund ta themi e ka një logjikë tipike komuniste, meqë ambasadori, i cili deri dje ishte më i miri dhe më i nderuari, sipas kësaj ministrie, shpallet spiun.

Nëse nuk pajtoheni me logjikën komuniste, atëherë po ju them që kjo është logjikë gebelsiane.

Në rast se Qeveria e Kosovës qenka shumë e shqetësuar për çështjen e spiunllëkut, atëherë si ta shpjegojmë faktin që personi, i cili është zëvendësministër në Ministrinë e

Forcës së Sigurisë, i cili është kapur duke bërë spiunazh, duke dërguar në Serbi të dhëna mbi armatimin e FSK-së, nuk është shkarkuar. Pra, çfarë është ky standard i dyfishtë? Spiunazhi është spiunazh.

Është tepër shqetësuese mënyra se si Ministria e Punëve të Jashtme i trajton diplomatët. Është krejtësisht amatore, është papjekuri do të thosha, është krejtësisht jodiplomatike, edhe në rast se një ambasador gabon, një shtet i pjekur, një shtet i cili e kupton se çfarë është diplomacia, e mbron dinjitetin e një ambasadori, sepse kështu e mbron dinjitetin e shtetit të vet.

Imagjinojeni se çfarë imazhi kemi krijuar ne me këtë lloj lëvizjeje të Qeverisë së Kosovës, imazhin e një shteti tërësisht të papjekur dhe për çfarë qenka larguar ambasadori. Sipas tij, ka thënë që Serbia duhet njohë pavarësinë e Kosovës/ Është krim të thuhet kështu, qoftë edhe nga një diplomat? Në fakt, kjo është gjëja më normale që do të duhej të ndodhte.

Kështu që ajo që mund të them është që Ministria e Punëve të Jashtme po vazhdon të sillet në mënyrë të papjekur dhe të papërgjegjshme në raport me diplomatët e saj, të cilët i ndërron sa herë u teket zyrtarëve politikë. Po e shkatërron atë shërbim diplomatik, i cili është ndërtuar pas pavarësisë me gjithë problemet e veta, por po e degradon gjithnjë e më shumë, dhe po vazhdon të veproj vetëm sipas interesave të ngushta, e jo sipas interesave shtetërore. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër i vetëm, Makolli,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ligji numër 04/L-092 për persona të verbër është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 14.6.2012.

Fushëveprimi i këtij ligji është rregullimi i të drejtave dhe përfitimeve, si dhe ofrimi dhe garantimi i mbrojtjes ligjore për afro 5 000 persona të verbër dhe me të pamë të dobësuar, sa ka Kosova në tërësi.

Madje, sipas dispozitave të këtij ligji, është përcaktuar që personat të cilët e gëzojnë statusin e personit të verbër do të marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar, duke u bazuar në pagën minimale në vendin tonë.

Sipas nenit 25 të këtij ligji, zbatimi i këtij do të fillojë nga janari i vitit 2013. Ndonëse tani po bëhen 6 muaj që nga data kur është dashur të fillohet me zbatimin e tij në praktikë, fatkeqësisht ende nuk kanë filluar të aplikohen dispozitat më të rëndësishme për këtë kategori tejet të ndjeshme të vendit tonë.

Ndërsa, arsyetimi i zyrtarëve të Qeverisë sonë për moszbatimin e këtij ligji është mungesa e mjeteve financiare.

Një arsyetim i tillë i kësaj Qeverie, në radhë të parë e tregon mënyrën e veprimit dhe të funksionimit të saj. Pra, veprim pa vizion dhe pa planifikim përkatës, madje edhe për çështjet më vitale për kategori të caktuara të qytetarëve të saj.

Më tutje, veprimi i tillë e vërteton faktin se kjo Qeveri është e interesuar për financimin e luksit të zyrtarëve të saj, siç janë veturat luksoze, derivatet e tyre, telefonat mobilë, udhëtimet zyrtare, drekat dhe darkat reprezentative, reklamat jashtë vendit, të cilat hyjnë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, për çka vetëm gjatë tremujorit të parë të këtij viti ka harxhuar mbi 37,8 milionë euro.

Andaj, nga kjo foltore e Kuvendit kërkoj prej Kabinetit qeveritar që gjatë rishqyrtimit të buxhetit të vitit 2013 t'i reduktojë mjetet buxhetore për nevojat luksoze të zyrtarëve të saj dhe në këtë mënyrë t'i sigurojë mjetet e nevojshme për zbatimin e Ligjit për persona të verbër dhe ligjet tjera të ngjashme me të cila do të plotësoheshin sadopak nevojat elementare të kategorive sociale të vendit tonë, të cilave u përkasin edhe personat e verbër dhe ata me të pamë të dobësuar. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Albana Gashi.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” me shumë shqetësim ka vërejtur se problemi i etheve hemorragjike në komunën e Malishevës është neglizhuar nga institucionet lokale dhe qendrore, edhe pse ky problem duhet trajtuar me urgjencë, sepse tashmë i kemi 15 qytetarë të vdekur si rezultat i pickimit nga rriqrat.

Plani që propozon Lëvizja “Vetëvendosje” është një plan orientues 5-pikësh, që do t'i jepte zgjidhje kësaj situatë të rëndë.

1. Qeveria e Kosovës ta marrë situatën nën menaxhim, duke e krijuar një shtab urgjence dhe ta ndajë një buxhet të mjaftueshëm për spërkatjen e të gjithë zonave endemike, duke e koordinuar një aktivitet në të gjitha komunat e prekura. Ky aktivitet duhet të fillojë menjëherë dhe të vazhdojë për tre vjet me radhë, pasi zhdukja e këtyre insekteve vdekjeprurëse nuk është e mundur vetëm për një vit.

2. Në kuadër të qendrës kryesore të mjekisë familjare të hapen qendra specialistike infektive, ku pacientët që në fillim të trajtohen nga infekteologu dhe të kryhen shërbime shëndetësore më afër pacientëve. Po ashtu, të ketë sensibilizim dhe mobilizim të qytetarëve mbi rrezikshmërinë e kësaj sëmundjeje dhe të ketë kujdes maksimal nga çdo lloj dyshimi për sëmundjen. Ky vetëdijësim duhet të realizohet nga një program informimi gjithëpërfshirës, informim i thjeshtë dhe praktik trevjeçar.

3. Të ndahet një fond i veçantë për bujqësi për 5 vjet me radhë për komunën e Malishevës, ku bujqit do ta gëzonin të drejtën e aplikimit në këto fonde dhe do t'i punonin tokat bujqësore që sot janë djerrina. Ky program do të ndikonte dukshëm në zhdukjen e këtyre insekteve, pasi punimi i tokave, por edhe rritja e mirëqenies, do të ishin në funksion të njëra tjetrës.

4. Të shfrytëzohet kapitali social. Në këtë pikë vlen të theksohet se shumë projekte me një qasje serioze mund të hasin në ndihmën e qytetarëve në të gjitha format dhe ky kapital do të duhej shfrytëzuar.

5. Lëvizja “Vetëvendosje” propozon që Qeveria lokale dhe ajo qendrore, institucionet shëndetësore, por edhe donatorët e mundshëm, të jenë seriozë në monitorimin dhe implementimin e këtij plani, duke qenë të përgjegjshëm dhe transparentë në këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Janë të parashtruara gjithsej 4 pyetje, por ministrat të cilët do të duhej të përgjigjeshin nuk janë të pranishëm.

Deputetë, a doni t’i parashtroni pyetjet? Për shembull, deputetja Justina Shiroka-Pula nuk është, i ka dy pyetje. Pastaj Danush Ademi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Ministri nuk është këtu. Deputet, dëshiron ta bësh pyetjen?

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryetar!

Edhe pse nuk është ministri këtu, unë do ta parashtroj pyetjen, sepse është shqetësim i qytetarëve. Pyetja ka të bëjë me Ligjin 04/96 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi, i shpallur me dekretin nr. 04/2012, i datës 30.5.2012, nga presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga.

I nderuar, në nenin të këtij ligji, paragrafi 4.5, thuhet: “Të drejtën e ndihmës sociale në kategorinë e dytë e realizon familja me një anëtar të familjes të aftë për punë dhe të paktën me një fëmijë nën moshën 5 vjeç, apo që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën 15 vjeç”. Duke e ditur se shumica e ashkalinjve janë në kategorinë e dytë, që e gëzojnë ndihmën sociale dhe pas nënshkrimit të këtij ligji, pikërisht të nenit 4.5, kjo do ta dëmtojë rëndë gjendjen e familjeve të ashkalinjve që e gëzojnë të drejtën sociale dhe rrezikojnë të largohen ata nga ndihma sociale për shkak se fëmijët, familjet tona bashkëjetojnë edhe me një numër të madh të vëllezërve dhe prindërit e tyre për shkak që nuk kanë hapësirë të ndahen, ose të kenë shtëpi të veta, dhe kështu ata që mund të jenë me më shumë se një anëtar që kanë të drejtë pune, por janë të papunë dhe kjo pikë e këtij ligji i largon nga ndihma sociale, që është i vetmi burim për ekzistencën e tyre në këtë kohë. Ata janë të papunë dhe nuk kanë burime tjera që të jetojnë.

Pyetja ka të bëjë me atë se sa ka mundësi të punohet një rekomandim shtesë dhe të sillët për votim në Kuvend, duke i respektuar të gjitha procedurat ligjore që të përmirësohet ky nen, ashtu siç ka qenë më herët dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYTARI: Faleminderit! Deputeti Agim Kuleta, pyetje për zëvendëskryeministren Edita Tahiri. A do ta bësh pyetjen? Jo. Atëherë vazhdojmë.

Në ndërkohë, në përputhje me nenin 22, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, janë parashtruar dy propozime për amendamentimin e rendit të ditës.

1. Kryeministri i Kosovës ka propozuar që pika e pestë - Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, dhe

2. Kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, zoti Ali Sadriu, ka propozuar, që pika 6 - Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012 të hiqet nga rendi i ditës për shkak se nuk e ka shqyrtuar raportin e auditimit, i cili ka qenë pjesë e raportit që është shqyrtuar.

Dhe, për këtë duhet t'i kemi 61 deputetë. I kemi 60. Duhet të votojmë për t'i hequr nga rendi i ditës këto pika . Regjia, ftoni deputetët me zile që të kthehen në sallë.

Do të thotë, duhet një votim formal për t'i hequr këto dy pika të rendit të ditës nga shqyrtimi i sotëm. Kush është për?

Faleminderit! Shumica janë. Kundër, a ka? Nuk ka. Konsideroj që Kuvendi i heq nga rendi i ditës pikat e cekura.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 6, 7 dhe 13 qershor 2013

Pyes nëse keni vërejtje në këto procesverbale? Të pranishëm janë 74 deputetë. Pasi nuk ka vërejtje, konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 6, 7 dhe 13 qershor 2013.

4. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me rregullimin e taksave të sigurimeve të automjeteve të udhëtarëve dhe automjeteve transportuese të mallrave

Diskutimi për këtë pikë ka përfunduar në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2013, mirëpo votimi është shtyrë për mbledhjen e radhës.

Vazhdojmë me votimin e propozim-rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me rirregullimin e taksave të sigurimeve të automjeteve të udhëtarëve dhe të automjeteve transportuese të mallrave.

Të pranishëm janë 80 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 44 vota për, 13 kundër, 10 abstenime, Kuvendi i miratoi rekomandimet lidhur me rregullimin e taksave të sigurimeve të automjeteve të udhëtarëve dhe të automjeteve transportuese të mallrave.

Pikën pesë dhe gjashtë i hoqëm nga rendi i ditës, kalojmë në pikën e radhës:

7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2012

Raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Kryetarja nuk është. Në emër të Komisionit, a do ta marrë fjalën dikush? Jo! Atëherë, vazhdojmë diskutimet me grupet parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Përshëndetje për kabinetin qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar e ka shqyrtuar raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2012 dhe e mbështet atë, duke besuar që mjetet të cilat janë të paadresuara për tatimpaguesit, të adresohen me kohë dhe të shkojnë me adresa të sakta, vlera e të cilave është mbi 17 milionë euro.

Grupi Parlamentar do ta votojë në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Edhe Grupi ynë Parlamentar e ka shqyrtuar raportin e Fondit Pensional për vitin 2012 dhe konsiderojmë që është një raport i mirë, me përmirësimin e konjunkturës ekonomike në vendet, ku paratë e Fondit Pensional janë të investuara. E kemi parë një performansë të mirë të këtyre mjeteve dhe ne e aprovojmë raportin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “Vetëvendosje”, kryetari Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta miratojë në parim këtë raport, por natyrisht se i kemi disa vërejtje, jo fort në raport, por në mënyrën se si funksionon

Trusti në përgjithësi, vërejtje këto të cilat janë vërejtje që i aplikohen pak a shumë çdo viti, meqenëse është natyra e sistemit pensional ajo që vërtet duhet të kritikohet dhe të ndryshohet.

Trusti i Kursimeve Pensionale është një institucion, i cili në njëfarë mënyre, edhe me rregullat ligjore që janë të aplikueshme në Kosovë, është i detyruar që të funksionojë ashtu siç funksionon, dhe në këtë drejtim konsideroj se kritika karshi këtij sistemi pensional është kritikë ndaj Ekzekutivit për mirëmbajtjen e kësaj forme të sistemit pensional, dhe jo domosdoshmërisht vetëm e një institucioni të caktuar që e ekzekuton atë sistem pensional.

Pra, është e qartë se një prej problemeve kryesore që ka ekzistuar përherë me Trustin, e që është edhe sot, është mënyra se si investohen këto mjete dhe ku investohen ato. Pra, kjo formë, ky organizim i sistemit pensional dhe këto kursime kombëtare - të qytetarëve të Kosovës, janë kursime të cilat nuk po gjejnë përdorim njëkohësisht për ta ndihmuar ekonominë e vendit dhe në mënyrë indirekte për t'i ndihmuar edhe këta kursimtarë.

Por, natyrisht se nuk po them që këto kursime duhet të shndërrohen tash në një fond zhvillimor, por Qeveria e Kosovës duhet domosdoshmërisht t'i krijojë mekanizmat, në mënyrë që këto para të mund të investohen për të mirën e ekonomisë së vendit. Pra, është jo e mençur dhe natyrisht edhe në kundërshtim me çfarëdo logjike ekonomike që kursimet kombëtare të vendit të mos gjejnë përdorim dhe shfrytëzim për zhvillimin ekonomik të vendit, siç ndodh, për shembull me këto para të kursyera nga qytetarët e Kosovës.

Një çështje tjetër që mund të thuhet për raportin, ose që del nga raporti, është edhe kjo tema, e cila është bërë goxha e madhe tash prej 1 majit, kur Enti i Statistikave doli me informatën pompoze se papunësia qenka zvogëluar për 10% në Kosovë dhe në raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale flitet për ata kontribuues, të cilët janë kontribuues në të. Pra, edhe që janë edhe të punësuar, edhe që janë të formalizuar si të punësuar.

Dhe, në këtë drejtim shohim që në vitin 2012, të formalizuar si të punësuar, pra kontribuues, të cilët kanë kontribuar gjatë tërë vitit në secilin tremujor si kontribuues aktivë, pra që nënkupton se kanë marrë në secilin tremujor paga dhe kanë paguar tatimin në të ardhura dhe kontribute pensionale, janë 183 008 persona, për shkak se thuhet që nga 266 026 kontribuues aktivë kanë qenë 68,8%, në raport, që nënkupton se janë 183 000 persona, të cilët gjatë vitit 2012 kanë qenë të formalizuar si të punësuar në Kosovë, e që nënkupton se kanë marrë paga të rregullta mujore, kanë paguar tatime në të ardhura rregullisht për çdo muaj dhe rrjedhimisht kanë paguar edhe kontribute pensionale rregullisht për tre muaj 183 000 persona.

Nuk dua të them me këtë se ky është i vetmi trup i punësuar nga qytetarët e Kosovës, nga fuqia punëtore e Kosovës, por dua të them se kjo tregon në njëfarë mënyre që, natyrisht, edhe papunësia është shumë më e lartë sesa që thuhet, por në fakt edhe informaliteti është shumë më i lartë sesa që përmendet këtu ndonjëherë.

Pra, ka një numër të konsiderueshëm të qytetarëve të Kosovës, të cilët me përjashtim të atyre që janë të punësuar sezonal, e që janë paraqitur këtu në raport, janë të punësuar ndoshta, por nuk janë të formalizuar si të tillë, dhe rrjedhimisht ata janë të përjashtuar nga privilegjet dhe benifitet formale-juridike, që mund t'i realizojnë nga sistemi legjislativ i Kosovës. Në këtë drejtim konsideroj që Qeveria duhet domosdoshmërisht të ndërmarrë masa nëpërmjet agjencive të veta, në mënyrë që këtë informalitet të ekonomisë së Kosovës ta luftojë, për shkak se nga kjo edhe po humb shteti, po edhe po humb qytetari në njëfarë mënyre.

Secili qytetar i cili për arsye të ndryshme nuk ka guxim apo mundësi që të kërkojë nga punëdhënësi i vet që të formalizohet, është duke humbur edhe nga moskontribumi në sistemin pensional, po edhe nga aspekte tjera që mund t'i marrë si i punësuar. Pra, kjo është një çështje që domosdoshmërisht duhet të adresohet, ndërkohë që në të njëjtën kaptinë të raportit thuhet që numri i kontribuuesve të rregullt për vitin 2012 është rritur për diku afro 10 mijë, 9 mijë e disa sosh, që nënkupton prapë që kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që është punësim i ri, po ka mundësi që është një lloj formalizimi i të punësuarve të cilët janë tashmë në Kosovë.

Në 183-mijëshen duhet ta kemi parasysh që bëjnë pjesë edhe të punësuarit në aparatet shtetëror, pra në ekzekutiv dhe në të gjitha institucionet publike të Kosovës, numër ky i cili është diku në nivelin e 75 mijë deri në 80 mijë persona. Pra, në fakt ata që punojnë në sektorin privat sipas këtij numri të Trustit e që janë njëkohësisht të lajmëruar si të punësuar, pra të formalizuar, përbëjnë jo më shumë se 100 mijë persona.

Pra, shihet që edhe në këtë drejtim kjo është një lloj dëmi shumë i madh ekonomik dhe i të drejtave të njeriut e të drejtave të punëtorëve, që i bëhet punëtorit në Kosovë dhe përgjithësisht ekonomisë së vendit.

Përfundimisht, pra siç e thashë Lëvizja “Vetëvendosje“ do ta miratojë këtë raport, për shkak se e paraqet sipas neve qartë dhe drejtë punën e Trustit, për çka që kjo punë për shkak të kufizimeve ligjore dhe aspekteve tjera nuk mund të jetë punë, me të cilën mund të pajtohem. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar këtë raport dhe në parim do ta përkrahim, për arsye se është një prej raporteve prej se ka filluar Trusti të sjellë raport në Kuvend, një prej raporteve më të mira. Dhe, mund të themi se është përmirësuar dhe është zvogëluar fondi rezervë në Bankën Qendrore të Kosovës, për arsye se për tatimpaguesit, për kontributdhënësit, organizatat dhe ndërmarrjet dhe institucionet dhe subjektet janë duke deklaruar saktë emrin dhe mbiemrin e personit, i cili ka dhënë

kontribut për pensionet, që deri më tani ka munguar kjo e dhënë dhe kanë mbetur mjete të mëdha në fond rezervë në Bankën Qendrore.

Por, një problem që kolegu më parë e ceku janë investimet. Ne duhet të insistojmë si Kuvend që përqindja e investimeve dhe paratë e Trustit Pensional të bëjnë investime më tepër në vend, për arsye se tani kemi ndërmarrje të cilat menaxhojnë mirë në Kosovë, kemi ndërmarrje që kanë një stabilitet financiar dhe në vend se këto ndërmarrje ne t'i financojmë, ne po japim para që t'i financojmë ndërmarrjet ose kompanitë jashtë Kosovës dhe po gjenerojmë me para tonë, po kanë rritje ekonomike vendet shumë më të zhvilluara, që s'kanë ndoshta nevojë për paratë tona, ndërsa ndërmarrjet tona, institucionet tona, kanë nevojë për para, sidomos për para kesh në qarkullim.

Kështu që, ne mund të ndikojmë që këto para tona të jenë në qarkullim me një përqindje më të madhe në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Pasi që raporti është gjithëpërfshirës dhe përmban të dhëna dhe informacione që kërkohen sipas ligjit, i njëjti përmbush obligimet ligjore dhe raportim që dalin nga ligji për fondet pensionale të Kosovës, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të SLS-së nuk ka të lajmëruar. Në emër të Grupit "6+", deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna Grupa "6+" je razmotrila godišnji izveštaj Fond za penzijske štednje, i uzimajući u obzir sve postignute performance u odnosu na prošlu godinu, podržao ovaj izveštaj. Hvala!

KRYETARI: Në emër të grupit "Zajednička Budućnost" nuk ka të paraqitur. Po mendoj që për komisionin është dashur të bëhet një raport, pse para disa vjetëve kanë qenë 300 mijë tatimpagues për do të thotë 300 të punësuar që kanë paguar tatime dhe tani janë 180 e sa mijë dhe ndoshta edhe sipërmarrësit këtu mund të na ndihmojnë, a i kanë të gjithë të punësuarit të regjistruar?

Megjithatë, pasi që s'kemi për debat shkojmë në votim të raportit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 57 vota për, 3 vota kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2012.

E përsëritim votimin, nuk i kemi 61. Atëherë u bëmë 61, pra? Ti je për, a?

Me 58 vota për, 3 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi raportin e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2012

Raportin vjetor të punës së Këshillit Kosovar për Trashëgimi Kulturor për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe Kuvendit i ka rekomanduar mosmiratimin e tij.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2012 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputetin Idriz Vehapi për arsyetimin e raportit me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më datën 5 qershor të vitit 2013, ka shqyrtuar raportin e punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2012 dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

Rekomandim:

I rekomandohet Kuvendit të mos e miratojë raportin e punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2012.

Arsyetim:

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më datën 5 qershor 2013 e ka shqyrtuar raportin e punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor, për vitin 2012 të prezantuar nga administrata e Këshillit. Pas debatit të zhvilluar lidhur me këtë çështje komisioni konstatoi se Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor nga gjysma e vitit 2012 nuk është funksional, për shkak se anëtarëve të këtij Këshilli iu ka skaduar mandati.

Komisioni me shumicë votash i rekomandon Kuvendit mosmiratimin e këtij raporti.

Të nderuar deputetë,

Edhe në vitin 2012 deri në gjysmën e vitit 2012 vetëm një anëtar i Këshillit ka qenë në detyrë dhe ky Këshill, që nga viti 2011 kur unë e kam udhëhequr këtë Komision, ka qenë në përbërje jo të plotë. Ne iu kemi drejtuar një herë me një raport për përfundimin e mandateve të anëtarëve të organeve të pavarura, të emëruara nga Kuvendi, me datën 16 dhjetor të vitit 2011 dhe, organet tjera të pavarura që kanë qenë, bordet e tyre janë plotësuar. Ndërkaq, në këtë Këshill nuk është plotësuar, sepse pengesë ka qenë ligji, i cili pritet që të amendamentohet, të rishikohet, të plotësohet dhe ndryshohet në Ministrinë e Kulturës, e cila është duke e punuar këtë ligj. Dhe, ne si komision jemi në pritje të këtij ligji, me të cilin qartësohen procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të këtij këshilli.

Derisa ky ligj nuk vjen, ne nuk kemi pasur mundësi të bëjmë ndonjë zgjidhje, për shkak se pengesë ka qenë ligji, i cili është në fuqi dhe i cili nuk parasheh procedurat e përzgjedhjes së këtyre anëtarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, kryetarja nuk është këtu. Meqenëse ky Komision ka rekomanduar që raporti të miratohet, unë mendoj që mungesa e Këshillit nuk është ndonjë arsye për mosmiratimin e raportit.

Atëherë, shkojmë sipas grupeve parlamentare. Në emër të Grupit të Partisë Demokratike kush e kërkon fjalën? Deputetja Xhevahire Izmaqi e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAQI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar raportin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor dhe do të mbajë të njëjtin qëndrim me atë të Komisionit Funkcional.

Pra, derisa ne nuk kemi aktualisht një bord që udhëheq apo asnjë anëtar të Këshillit edhe raporti ndoshta ka kaluar nëpër procedura jo të rregullta që ka ardhur në Kuvend, për arsye se ne raportin edhe në Komision edhe këtu e kemi marrë pra, drejtpërdrejt nga sekretaria, nga stafi ekzekutiv.

Ne presim që në të ardhmen ose në një kohë sa më të shpejtë, Ministria të marrë një vendim, po edhe ne si Kuvend nuk mund të amnistohemi nga përgjegjësia, për arsye se ka dy vjet që e kemi ditur që nuk ka mandat, apo nuk ka mandat asnjë anëtar i këtij Këshilli. Derisa edhe ky Këshill ka funksionuar me një ligj të vjetër, nga koha e UNMIK-ut, i cili nuk përcakton kriteret të cilat duhet t'i kenë për vendosjen e anëtarëve të rinj apo mosekzistimit fare të këtij Këshilli.

Me gjithë votimin negativ të këtij raporti, ne e konsiderojmë që pjesa ekzekutive e Këshillit e ka kryer një punë të mirë. Po ashtu, edhe raporti financiar është vlerësuar pozitivisht, megjithatë derisa ne nuk përcaktohem që të ketë apo të mos ketë një Këshill, nuk mund ta votojmë pro.

Po ashtu, dilemat qëndrojnë edhe tek vetë Ministria, e cila nuk është e definuar qartë, nëse do ta mbështesë vazhdimin e funksionimit të Këshillit për Trashëgimi Kulturor duke ditur faktin se Ministria e Kulturës ka arritur ta ngrejë nivelin e dikasterit në departament, pra kështu që kemi edhe një lloj dualizmi të këtyre dy fushave.

Deri në atë moment që ne do të përcaktohem qartë nëse duhet apo jo të ekzistojë ky Këshill, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike këtë radhë do të votojë për jo, nuk do ta votojë raportin.

KRYETARI: Në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike, deputetja Lirije Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kuvendi i Kosovës me qëllim të fuqizimit të mbrojtjes ligjore të trashëgimisë kulturore ka nxjerrë Ligjin për trashëgimi kulturore të Kosovës dhe neni 4.8 i këtij ligji e nxjerr edhe Këshillin për Trashëgimi Kulturor të Kosovës.

Ky Këshill është institucion i pavarur, i krijuar në bazë të këtij ligji dhe mandati i tij është vlerësimi dhe shpallja e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, fuqizimi dhe zhvillimi i këtij institucioni është kërkuar dhe është përshëndetur. Vazhdimisht është kërkuar një fuqizim i tillë edhe nga raportet e progresit të secilit vit, duke filluar nga 2008, 2009, 2010, 2011 e në vazhdim, prandaj kjo i nxjerr obligime edhe institucioneve të Kosovës, për më shumë vëmendje për këtë Këshill.

Qëllimisht përmenda mandatin e këtij Këshilli, për të thënë se u tha më herët që normalisht diçka është punuar, por nuk është punuar në suaza të mandatit, i cili thashë kryesor është vlerësimi dhe shpallja e trashëgimisë nën mbrojtje të përhershme.

Ende sot nuk është lista e përhershme, që është e pafalshme për institucionet e Kosovës, prandaj, hamendjet e Ministrisë së Kulturës për pozicionimin e këtij Këshilli, i varur apo i pavarur, po krijojnë shumë minuse në fushën e trashëgimisë kulturore dhe në këtë drejtim edhe institucioneve të Republikës së Kosovës dhe zgjatja e kësaj hamendjeje është e pafalshme.

Prandaj, si Lidhje Demokratike e Kosovës kërkojmë më shumë vëmendje në këtë drejtim. Të plotësohen anëtarët e Këshillit, të vazhdojnë me punën që është shumë e nevojshme, ngase prekin shumë ligje. Ne i përmendëm Ligjin e trashëgimisë kulturore, po edhe Ligji për zonat e mbrojtura edhe ligjet tjera, si Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit e tjera, janë ligje të cilat e presin këtë këshill për ta thënë fjalën e vet.

Dhe ta them të fundit, mbështetet raporti i Komisionit dhe vlerësimi i tij për ta refuzuar këtë raport, si të pamjaftueshëm. Faleminderit.

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe ne gjatë shqyrtimit të këtij raporti jemi ndodhur në një situatë paradoksale, sepse në fakt duhet të vlerësojmë një raport të një trupe që realisht është inekzistent tash e sa kohë, por që në të vërtetë Këshilli nuk është fajtor pse është inekzistent, por janë institucionet qendrore dhe veçanërisht Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës, që kanë mandat dhe duhet ta kompletojnë këtë institucion, i cili është institucion i pavarur dhe kushtetues që ka në funksion mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Është e ditur se bordi i këtij institucioni ishte konstituuar me inicimin që pat bërë Kryesia e Kuvendit në mandatin e kaluar, mirëpo kur skadoi mandati i anëtarëve të këtij bordi, më pastaj asnjëherë nuk u konstituua dhe nuk u kompletua. Por, puna është se ne tash kemi një raport që prezanton një punë që ka kryer pra pjesa tjetër e Këshillit, por nuk kemi një bord që do ta kompletonte këtë Këshill.

Dhe ne nuk kemi si të mos pajtohemi tash me konstatimet e këtij raporti. Ne jemi në një situatë ku kemi një raport i cili adreson shumë çështje shqetësuese mbi gjendjen e trashëgimisë kulturore, por nuk kemi një Këshill. Dhe, ky raport për shembull tash thotë se Republika e Kosovës pranë detyrimeve ligjore të përcaktuara në mënyrë të qartë, ende nuk ka arritur t'i identifikojë potencialet e trashëgimisë kulturore për mbrojtje.

Shprehjet e pasura materiale dhe jo materiale në shtrirje të gjerë territoriale vazhdojnë të mbeten pa status të definuar të mbrojtjes dhe në mëshirë të zhvillimeve të pakoordinuara bashkëkohore. Kështu që ne nuk kemi si të mos pajtohemi me këto konstatime të këtij raporti apo rekomandimet që i jep ky raport për t'u zgjidhur kjo situatë, ku ai propozon funksionalizimin e inventarit të trashëgimisë kulturore, përzgjedhje dhe përgatitje e propozimeve për shpallje të mbrojtjes së përhershme, vlerësimin dhe propozimin e shpalljes së pronave të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, vlerësimin e projekteve në sektorin e trashëgimisë kulturore. Dhe, njëri nga rekomandimet e këtij Këshilli është që Kuvendi i Kosovës duke njohur rëndësinë e ruajtjes dhe potencialit të trashëgimisë kulturore në funksion të fuqizimit aktiv dhe efektiv të normativës ligjore të Republikës së Kosovës, besojmë se pa hezitim do të bëjë emërimin e shtatë anëtarëve të KKTK-së.

Pra, në njëfarë mënyre edhe ata që e kanë shkruar këtë raport kërkojnë intervenim urgjent nga Kuvendi i Kosovës, që të kompletohet ky bord. Dhe, ne nuk kemi si të mos pajtohemi me këto rekomandime dhe kërkesa të pjesës së sekretariatit, kështu që ne me këtë rast, në njëfarë mënyre e kemi imperativ që t'i votojmë këto kërkesa, në mënyrë që Kuvendi ta marrë shumë seriozisht këtë gjendje dhe të gjejë mekanizma urgjent për kompletimin e këtij Këshilli, që ky ta kryejë punën e tij në përputhje me funksionin kushtetues që e ka, për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, që me të vërtetë është në gjendje shumë të mjerë, tani për tani. Faleminderit!

KRYETARI: Ne emër të Aleancës, deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,
Sot kemi në shqyrtim raportin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2012.

Që në fillim unë pajtohem me propozimet e Komisionit që ky raport të mos votohet. Është çështje urgjente e Kuvendit të Kosovës, që ka themeluar këtë këshill, që të punojë në mënyrë që të ketë jo vetëm anëtarë Këshilli, por ta ketë përbërjen e plotë. Sot, të nderuar deputetë, nuk është asnjë anëtar i këtij Këshilli dhe fillimisht të gjitha raportet, së pari duhet të miratohen në Këshill.

Sikur të ishte quajtur raporti i administratës së këshillit, ne normalisht se do ta kishim votuar, sepse rekomandimet që janë brenda këtij raporti janë me interes për funksionimin e këtij Këshilli, por quhet raporti i Këshillit a Këshill nuk kemi.

Është një shqetësim që Kuvendi nuk e ka marrë asnjëherë seriozisht për funksionimin e këtij Këshilli, pra të jenë anëtarët. Qysh vitin e kaluar, domethënë qysh më 2011, në fakt ky Këshill ka funksionuar edhe ashtu me përbërje gjysmake, asnjëherë nuk e ka pasur kuorumin, gati prej se jemi ne si legjislaturë.

Prandaj është dilema ne nuk do ta votojmë, por çka do të bëhet me mosvotimin, por edhe nëse e votojmë, çka do të bëhet me votimin?

Pra, edhe njëherë duhet të qartësohen, duhet të vijë ligji, të dihet së pari, se as me ligjin aktual nuk dihet se si emërohen këta anëtarë të këshillit. Është një shqetësim që na përcjell vite pas vitesh.

Pra, anëtarët e këshillit nuk janë dhe ne nuk do ta votojmë, sepse nuk mund të quhet raport i administratës së këshillit, por është raport i këshillit, andaj nuk do ta votojmë. Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Por, merreni përgjegjësi si Kuvend, që nuk është e Kuvendit, por megjithatë vazhdojmë.

Fjalën e ka në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit Parlamentar, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar raportin e punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2012. Dhe në rast se nisemi nga raportet të cilat vijnë në Kuvend të Kosovës, që të miratohen nga organet e pavarura në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, atëherë shtrohet pyetja: Çka ka kërkuar Qeveria që nuk e ka plotësuar deri më tani Këshillin? Dhe, gjithë ankesat që janë drejtuar sot në këtë debat dhe arsyetimi i cili është dhënë po nga Komisioni përgjegjës, thuhet se pas debatit të zhvilluar lidhur me këtë çështje Komisioni konstatoi se Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore nga gjysma e

vitit 2012, nuk është funksional, për shkak se anëtarëve të Këshillit iu ka skaduar mandati. Ata nuk janë fajtorë pse iu ka skaduar mandati.

Dhe në anën tjetër e kemi rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili e përkrah këtë raport, domethënë, taksapaguesit e Kosovës të cilët kanë dhënë para për këtë këshill, Komisioni për Buxhet dhe Financa e jep dritën e gjelbër. Atëherë, nuk e di pse ngel faji tek raporti i Këshillit kur faji është diku tjetër? Dhe në rast se ne si Kuvend miratojmë raporte të këshillave dhe agjencive të pavarura, ne kemi për obligim t'i themi Qeverisë, që në afatin sa më të shkurtër, në bazë të ligjit në rast se ligji ka mangësi atëherë Kuvendi është ai i cili ndryshon ligjet, që të vijë plotësim-ndryshimi i ligjit dhe njëkohësisht të miratohen raportet, se ne i kemi dhënë të hollat nga Buxheti i Kosovës për këtë Këshill.

Dhe, tash thuhet se me të holla ka shkuar gjithçka në rregull, ndërsa raporti i Këshillit nuk duhet të pranohet për arsye se Këshilli nuk është me mandat të plotë, atëherë përgjegjësia mbetet diku tjetër, nuk duhet të mbetet te deputetët. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të ri “Zajednička Budućnost”, Milivoje Stojanović e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala predsedniče!

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” neće glasati za izveštaj Kosovskog saveta za kulturno nasleđe 2012.godine iz prostog razloga, zato što ovaj izveštaj koji smo dobili nije čitak, nije razumljiv na srpskom jeziku. Onog trenutka kada ga dobijemo na kvalitetnom srpskom jeziku onda ćemo moći da ga analiziramo i prema tome ćemo se opredeliti. Zahvaljujem!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Duke pasur një konsideratë të veçantë për trashëgiminë kulturore dhe duke ditur se këtë Këshill e kanë përcjell shqetësime jashtëzakonisht të mprehta, të theksuara, të dukshme dhe të atilla çfarë i nënvizuan të tjerët, dua të bëj dy propozime të cilat telegrafikisht do të mundohem t'i përmbledh në këtë përkufizim.

Ligji për trashëgimi kulturore duhet të sillet në Kuvend me plotësime dhe ndryshime, me një procedurë të ngutshme dhe duke e trajtuar nga ekspertë dhe njohës të mirë të komisioneve përkatëse.

Gjithashtu, Këshilli për Trashëgimi Kulturore duhet të plotësohet dhe të funksionojë në të mirë dhe në begatimin e gjithë kësaj problematike, gjithë kësaj fushe që duhet të trajtohet me kompetencë dhe me përgjegjësi të merituar. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë desha të sqaroj sa i përket raportit të trashëgimisë kulturore, duhet ta dimë që këtë raport e ka përgatitur stafi menaxhues dhe nuk e kanë përgatitur anëtarët e Këshillit, edhe pse unë kam vërejtje se po bëhen plot 3-4 vjet që ky Këshill do të thotë nuk është komplet dhe nuk është funksional. Por, raportin e ka përgatitur stafi menaxhues kur dihet që ky Këshill e ka një drejtor dhe i ka disa anëtarë tjerë. Dhe në këtë raport decidivisht shkruan qartë- për aktivitetet të cilët i ka zhvilluar Këshilli i Trashëgimisë Kulturore gjatë periudhës së vitit 2012.

Njëkohësisht, do të thotë pjesa më e madhe e raportit ka të bëjë edhe me buxhetin për trashëgiminë kulturore për të cilin e ka marrë rekomandimin nga Komisioni Funksional, por në këtë rast duhet të dallohet, do të thotë që Këshilli për Trashëgimi Kulturore është një trup i cili nuk harton raport, por është stafi menaxhues që harton raportin e punës së Këshillit të Trashëgimisë Kulturore në përgjithësi.

Dhe, pse nuk është funksional ky trup ose ky Këshill me anëtarë tjerë të Komisionit, ligji ekzistues është në fuqi, mendoj që duhet që në një të ardhme shumë të shpejtë, sepse ka obligim edhe Kuvendi i Kosovës, në bashkëpunim edhe me partitë politike që janë prezent që e përfaqësojnë Kuvendin e Kosovës, të propozojnë anëtarët e Këshillit, sepse kështu ka qenë edhe formimi i parë, do të thotë i këtij Këshilli dhe kështu e parasheh edhe ligji. Dhe, njëkohësisht nëse ne presim ligjin që do të vijë deri diku kah tetori, sipas kalendarit që e ka Ministria e Kulturës, atëherë do të jetë shumë vonë, sepse ky ligj nuk do të hyjë në fuqi deri në vitin 2013. Prandaj, po i bie që tri vjet, Këshilli për Trashëgimi Kulturore do të thotë e vazhdon punën e vet me aktivitetet e veta, por njëkohësisht gjysmak është Këshilli që nuk plotësohet me anëtarë tjerë.

Pra, duhet të dallojmë qartë raportin që e përgatit stafi menaxhues dhe Këshilli që e bën punën e vet, prandaj këtu kemi të bëjmë me raportin që e ka përgatitur stafi menaxhues. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk ka të lajmëruar për diskutim dhe po e shoh të nevojshme të jap këto sqarime.

Kuvendi më shumë se një herë ka kërkuar nga Qeveria për të gjitha komisionet dhe bordet që janë të pakompletuara ta bëjnë propozimin e kandidatëve për këto komisione dhe borde.

Përgjegjësinë nga Kuvendi për mbikëqyrjen e komisioneve të pavarura dhe të bordeve që i përgjigjen Kuvendit e kanë komisionet përkatëse.

Unë konsideroj se Komisioni përkatës është dashur t'i japë këto rekomandime:

- Të kërkojë zbatimin e ligjit që është në fuqi dhe kompletimin e Komisionit të pavarur me kandidatët që parashihen me ligj;

- Miratimin e raportit, siç e ka dhënë Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe tjetra, nëse nuk është i kënaqur me ligjin në fuqi, të kërkojë nga Ministria përkatëse dhe Qeveria që ligji të sillet në Kuvend.

Nuk e shoh asnjë arsye për mungesë të Bordit ose Komisionit Mbikëqyrës që ky raport mos të miratohet, pasi Komisioni për Buxhet dhe Financa ka dhënë rekomandimin për miratimin e tij.

Unë mendoj se këto do të duhej të ishin rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL në lidhje me këtë Këshill.

Megjithatë, votat janë tuajat, përgatituni për votim ju dhe regjia, votojmë tash.

Me 26 vota për, 33 kundër, 6 abstenime, Kuvendi nuk e miratoi raportin vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore për vitin 2012.

Po, cilët do të jenë hapat tjerë që do të merren pas mosmiratimit, le të mendojnë deputetët.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i kërkesës për transferin e mjeteve nga Ministria e Punëve të Brendshme në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar kërkesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme për transferin e mjeteve buxhetore nga Ministria e Punëve të Brendshme në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Fjalën ia kisha dhënë ministrit të Punëve të Brendshme, zotit Bajram Rexhepi, si propozues i çështjes.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Parlamentit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Kryetari e shpjegoi në pika të shkurtra kërkesën tonë për transferim të mjeteve në vlerë prej 1 milion euro nga Fondi për Integrim, i cili deri më tani kanë qenë nën menaxhim të Ministrisë së Punëve të Brendshme për arsye të rolit koordinator që e ka Ministria e Punëve të Brendshme.

Ne shpjegimet i kemi bërë edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa, me kërkesën që kjo vlerë prej 1 milion eurove të transferohet në Ministrinë e Ambientit e të Planifikimit Hapësinor, konkretisht në Departamentin për Rindërtim edhe Banim, për arsye se ata i kanë kapacitetet menaxhuese dhe po ashtu e udhëheqin finalizimin e ndërtimit, rindërtimit apo pajisjes së shtëpive.

Edhe vitin e kaluar, me rishikim të buxhetit, është kërkuar që këto mjete të transferohen në Ministrinë e Mjedisit e të Planifikimit Hapësinor me një vendim të Bordit për Implementim, por kjo s'ka ndodhur dhe Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor ka obligime të trashëguara edhe nga viti i kaluar ka hyrë në aranzhmane të ndërtimit të shtëpive dhe mjetet nuk mund të zotohen.

Ka pasur edhe kërkesa të ndryshme që kjo çështje të shtyhet deri me rishikim buxhetor, por të nderuar deputetë, mund t'ju them se të gjitha procedurat e rishikimit mund të shkojnë e s'dua të paragjykoj, por deri pas korrikut ose në shtator dhe atëherë të alokohen mjetet do të jetë shumë vonë për ndërtimin e shtëpive.

Në këtë rast do të pësojnë personat që janë kthyer dhe të cilët kanë nevojë që t'u ndihmohet dhe po ashtu do të dëmtohet shumë procesi i liberalizimit të vizave, për arsye se Kosova e ka një kapitull zero, që quhet, çështjen e riintegritit dhe nëse mjetet të cilat i ka alokuar Qeveria dhe me aprovim të Parlamentit, nëse nuk shpenzohen konform Ligjit për menaxhimin e buxhetit në mënyrën e duhur, atëherë procesi i liberalizimit të vizave rrezikohet shumë me këtë çështje.

Tash mund të themi se faji është jetim pse nuk është bërë përcaktimi në vijën buxhetore të Ministrisë, realisht në Ministrinë e Financave, nganjëherë edhe e bëjnë atë 'copy paste', që e quajnë, mirëpo, mund të them që edhe stafi ynë i cili ka qenë përgjegjës nuk i ka ndenjur gati këtyre gjërave dhe ata e shpjegojnë si një lëshim teknik, përndryshe kërkesa ka qenë edhe nga viti i kaluar.

Unë ju kisha lutur për mirëkuptim, jo për hir vetëm të Ministrisë që e udhëheq, por për hir të procesit të liberalizimit të vizave dhe përfituesve nga ky fond, që ta votoni dhe të fillojnë të vazhdojnë procedurat sa më shpejt me ndërtimin, rindërtimin dhe pajisjen për personat e rikthyer. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Komisionit për Buxhet e Financa, fjalën e ka deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Ministria e Punëve të Brendshme, pas konsultimeve me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Ministrinë e Financave dhe në pajtim me nenin 13, paragrafi 5 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës i është drejtuar me kërkesë Kuvendit për miratimin e kërkesës për transferin e mjeteve buxhetore nga Ministria e Punëve të Brendshme në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Komisioni për Buxhet e Financa, si Komision funksional, e ka shqyrtuar kërkesën edhe e ka hartuar raportin me rekomandime për Kuvendin.

Vlerësojmë si Komision se kjo është një çështje që është vetëm përmirësim teknik, që është një transfer i mjeteve ndërmjet ministrive përkatëse për shumën, e cila veç është e paraparë në buxhetin për vitin 2013.

Duke e vlerësuar rëndësinë e realizimit të projektit në pajtim me procedurat ligjore në fuqi, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit që në pajtim me nenin 13, paragrafi 5 të Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës, për miratimin e kërkesës së transferim të mjeteve buxhetore prej 1 milion eurove nga Ministria e Punëve të Brendshme te Ministria për Mjedis.

Programi i riintegrit, kodi 209 i projektit kapital, ndërtimi i shtëpive dhe rehabilitimi i objekteve banesore për persona të riatdhesuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, respektivisht në Departamentin e Banimit dhe Ndërtimit që e ka kodin 604, në kategorinë ekonomike, investime kapitale.

Zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për transferin e këtyre mjeteve e përkrah edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Një çështje në fund, zoti kryetar, dikush mund këtu të shtrojë pyetjen - pse kjo të bëhet në këtë procedurë dhe mos të bëhet në rishikim? Pra, janë këto çështje që i tha ministri, kemi të bëjmë me kohën për arsye se rishikimi vetëm ka ardhur në Parlament, por në procedurat e shqyrtimeve nëpër komisione mund të marrë kohë, ndoshta një muaj e ndoshta edhe më tepër, prandaj kemi paraparë që kjo procedurë është e bazuar në ligj, e përshpejton procedurën dhe është konform kërkesës që e kanë bërë të dy ministrinë përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Partisë Demokratike, deputetja Hasime Krasniqi e ka fjalën.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar kërkesën për transferimin e mjeteve nga Ministria e Punëve të Brendshme në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nga Fondi për Integrim dhe pas arsyeshmërisë, të cilën e dhe edhe ministri, duke besuar edhe në rekomandimet të cilat i ka dhënë Komisioni Funkcional për Buxhet e Financa, Grupi Parlamentar do ta mbështesë këtë kërkesë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryetar!

Për bartjen e këtij zëri buxhetor nga një Ministri në Ministrinë tjetër, mendoj që nuk janë dhënë arsye të duhura, ose njëkohësisht janë fshehur arsyet reale të po kësaj bartje.

Ky “gabim” është i dyfishtë, në radhë të parë pse me copy-paste është ndërtuar buxheti i Republikës së Kosovës dhe po ashtu e dyta është që në mënyrë artificiale në buxhetin e Republikës së Kosovës të vitit 2013, pra në buxhetin e Ministrisë respektive, në këtë rast të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është rritur shifra e kësaj Ministrie, pra në mënyrë artificiale, gjë që ka qenë po ashtu edhe një që nuk mbetet thjeshtë në suaza të gabimit.

Edhe ashtu buxheti për vitin 2013 i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka qenë një buxhet i zvogëluar nga viti paraprak, pra i zvogëluar me fokus të veçantë në dy fusha të rëndësishme dhe mos të harrojmë që buxheti për operacione speciale pothuaj se është i suspenduar në Policinë e Kosovës dhe po ashtu pothuaj se i suspenduar është edhe buxheti për hetime.

Janë këto dy fusha ku së paku, për shkak të specifikave, për shkak të ngjarjeve dhe për shkak të natyrës së punës së tyre do të duhej të ishin të mbështetura, që i bie do të duhej të ishin të rritura nga viti paraprak, kurse në vitin 2013, këto dy fusha ose buxheti për këto dy fusha pothuaj se është i suspenduar.

Në këtë rast ne vlerësojmë që nuk kemi të bëjmë këtu për një transferim të një zëri buxhetor më shumë se sa për një transferim të një zëri korruptiv, për shkak se tashmë është e ditur që ndërtimi dhe rehabilitimi i objekteve banesore për persona të riatdhesuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme njëkohësisht është edhe një aferë korruptive e cila tashmë është bërë e ditur edhe publikisht, kështu që si të tillë ne nuk mund të jemi një mekanizëm i bartjes së këtyre aferave korruptive nga një Ministri në Ministrinë tjetër.

KRYETARI: Në emër të AAK-së, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar!

Ministër,

Kolegë deputetë,

Si deputet në Komisionin për Buxhet kam përkrahur që të bëhet alokimi i këtyre mjeteve nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nuk po dua të ndërhy për arsyet, por arsyet kryesore kanë qenë që të ketë një azhuritet më të mirë me qëllim të ndërtimit dhe rindërtimit, me qëllim të integritetit të njerëzve të rikthyer.

Unë edhe atë ditë në Komision, ministrit të Punëve të Brendshme ia kam cekur disa raste konkrete që njerëzit e kthyer nga vendet e Evropës Perëndimore, me vite të tëra të cilët janë duke u ballafaquar me ndërtim dhe rindërtim, ndërsa paratë mbesin në buxhet, në Ministri.

Unë besoj se qysh në fillim, nuk është dashur këto para të jenë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për arsye se edhe nëpër komuna janë zyrtat lokale të komuniteteve të cilat po merren me personat e rikthyer për integrim dhe ato zyre lokale të komuniteteve nuk e kanë asnjë cent në buxhet. Atëherë, kemi krijuar mekanizma të shumtë që merren me kthim dhe gjoja për ta plotësuar një kriter për liberalizim të vizave, ndërsa buxheti ka mbetur ende në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pa u harxhuar dhe arsyeja kryesore që ka qenë pro, është me qëllim që këto mjete mos të mbesin suficit, por në të vërtetë t'u ndërtohet njerëzve shtëpitë dhe të akomodohen e integrohen dhe mos të jetë një minus për liberalizim të vizave. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit Parlamentar, Myzejene Selmani e ka fjalën

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përhëndetje për ministrin dhe për deputetët,

Duke marrë parasysh se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka dhënë rekomandimin lidhur me kërkesën për transferimin e mjeteve nga Ministria e Punëve të Brendshme në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ekskluzivisht ministri dha arsyet e çështjes së ndërrimit të linjës buxhetore nga Ministria e Punëve të Brendshme në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, atëherë mund të themi se jemi të obliguar t'i plotësojmë konditat për çështjen e liberalizimit të vizave, mirëpo shpresoj dhe besoj që kur të bëhet ndarja e buxhetit të jenë më të saktë në kërkesat e tyre, që është e drejtë që të bëhet edhe ndërrimi në rast se aty do të mbesin paratë, pse të mbesin kur mund të shfrytëzohen në Ministrinë e Mjedisit e Planifikimit Hapësinor.

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet e Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-së deputetja Jasmina Zhivković, e ka fjalën.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Hvala predsedavajući!

Uvažene kolege,

Samostalna liberalna stranka podržace zahtev za transfer sredstava iz Ministarstva unutrašnjih poslova u Ministarstvu životne sredine i prostornog planiranja jer smatramo da je ovo od izuzetnog značaja za Ministarstvo koje se novac prebacuje, uz napomenu da svako ministarstvo i svaka institucija u budućnosti prikladno i lepo planiraju svoje budžete kako bi mogli normalno da ih iskoriste. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, nuk ka. Në emër të Grupit “Zajednička Budućnost”, Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost”, podržava preporuke Komisije za budžet i finansije za transfere sredstava iz Ministarstva unutrašnjih poslova na Ministarstvo životne sredine zbog specifičnosti projekta za koja su ta sredstva namenjena. Hvala!

KRYETARI: Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Po dua ta zë vetëm një pjesë të kësaj çështje pa dashur të lëshohem në detaje. Mendoj se me vite e vite, procesi i buxhetimit në Kosovë dhe dija e administratës për hartim të buxhetit i cili vjen të votohet në Kuvend, duhet të përmirësohet. Do të thotë ne duhet ta shohim një proces i cili e sjell shtetin dhe administratën deri te një situatë në të cilën ka shumë pak nevojë për ndryshime të këtilla.

E vërteta është se për çdo vit, për çdo tremujor, ne kemi situata në të cilat duhet të bëjmë ndryshime në buxhet për shkak se dikush ka qenë i pa aftë të parashohë gjëra të cilat kanë qenë dashur të jenë tepër evidente.

Një diskutim të ngjashëm e kam pasur vitin e kaluar menjëherë pas miratimit të buxhetit ose tre muaj më vonë ne ka qenë dashur të bëjmë ndryshime të mëdha për shkak se dikujt në Qeveri nuk i ka ra në mend se ato çështje janë të rëndësishme ose se një projekt i caktuar, cilido qoftë ai, duhet të mbulohet me mjete nga buxheti.

Kjo po ndodh edhe tash e pavarësisht se cilat janë arsyet që jepen, pavarësisht se a ka shpjegim racional mbrapa kësaj që po ndodh e që unë personalisht dyshoj, prapëseprapë esenca është se nuk po mund Qeveria e Kosovës dhe administrata jonë të mbërrijnë deri në një pikë kur e kupton se duhet mësuar për çdo vit, për çdo muaj, në mënyrë që të mos ketë nevojë të bëjë këso ndryshime.

Mendoj se kjo duhet të shënohet, në njëfarë forme është një sinjal i vogël se ka edhe shumë të mëdhenj tjerë, që tregojnë karakterin e administratës, kulturën e ndërtuar administrative në Kosovë dhe kulturën e ndërtuar politike në Qeveri të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin,

Të nderuar deputetë,

Besoj se është potez i qëlluar, mirëpo duhet një sqarim shtesë ta bëjmë, se ky fond është fond i posaçëm për ripanim, fond i posaçëm i cili është krijuar në nivel qeveritar dhe në cilin fond janë derdhur mjete, posaçërisht për procesin e riprimit që nevojiten mjete financiare për shumë dimensione të procesit të riprimit prej ndërtimit të shtëpive, riparimit të shtëpive, kontrolleve mjekësore, gjegjësisht në drejtimin shëndetësor, rrugëve, udhëtimeve që bëhen për kthim të ripranuarve e tjerë, dhe faktikisht këto mjete veç kanë qenë të dedikuara për të njëjtin destinim, domethënë për rindërtim të shtëpive dhe të këtij fondi.

Mirëpo, pasi Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka mekanizëm të posaçëm për ta mbikëqyrë ndërtimin e shtëpive apo riparimin e shtëpive, atëherë mekanizmi që e ka Ministria e Mjedisit Hapësinor është një mekanizëm i ndërtuar, mekanizëm që ka traditë dhe përvojë dhe vetëm kjo është arsyeja pse ato mjete po bartën, pjesa për rindërtimin e shtëpive te Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e jo te Ministria e Punëve të Brendshme. Dhe, ashtu Qeveria jonë për këtë destinim i ka ndarë këto mjete. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk kemi më të lajmëruar për diskutim. Shkojmë në votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Të pranishëm janë 77 deputetë.

Me 53 vota për, 1 kundër dhe 15 abstenime, Kuvendi e miratoi kërkesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme për transferin e mjeteve buxhetore nga Ministria e Punëve të Brendshme në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor.

Këtu e përfundojmë seancën. Mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë